Aneksi I

## Kerkesat e Autoritetit

### 1. Dokumentat e Procedures Konkuruese

i. Kapaciteti professional
ii. Kapaciteti teknik
iii. Kapaciteti financiar
iv. Kapaciteti ekonomik
v. Kriteret e vleresimit
vi. Kushtet e pa negociueshme
vii. Termat e references

46

# Aneksi II

## Oferta e Konçesionarit

Aneksi III

## CERTIFIKATA E PRANIMIT TE DOREZIMIT

Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të Republikës së Shqiperisë (Autoriteti Kontraktues) ose në përputhje me Kontratën e Koncesionit për Shërbimin e Detyrueshëm të Kontrollit Teknik të Automjeteve dhe Mjeteve te Lëvizshme në Shqipëri, e nënshkruar rregullisht, ndermjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit me ______/______/2009, bie dakort dhe pranon kalimin nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues te objekteve te meposhtme te Koncesionit.

| Objektet e Koncesionit | Specifikimet Teknike dhe Pershkrimi |
| --- | --- |
| (a) | |
| (b) | |
| (c) | |
| (d) | |
| (e) | |

Objekte te tjera.

1.Asetet e mesiperme kalohen nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues ne perputhje me termat dhe kushtet e Kontrates.

2.Autoriteti Kontraktues miraton dhe pranon objektet e mesipern Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues ne perputhje me termat

## Aneksi IV

### Testimi

Nje muaj perpara fillimit te fazes se pranimit te punimeve, Koncesionari do te dergoje nje plan te testimit me qellim qe te verifikoje perputhshmerine e sistemit te vendosur me percaktimet e hollesishme te tij, sic percaktohet ne Aneksin 1 dhe 2.

Koncesionari do t'i siguroje Autoritetit K[redacted] e testimit, sic percaktohet ne paragrafin e mesiperm.

Aneksi V

## Kushtet Standarte te Nenkontraktimit

1. Ne perputhje me kerkesat e nenit 10 te Kontrates, vendosen keto kushte standarte per lidhjen e nenkontratave ndermjet Koncesionarit dhe personave te trete

    - Nenkontraktori duhet te jete person juridik i rregjistruar ne QKR/Gjykate, organet tatimore dhe ne cdo institucion tjeter kur ka detyrim ligjor
    - Te mos jete i denuar per vepra penale lidhur me veprimtarine e tij si subjekt juridik
    - Nenkontraktoret duhet te jene te licensuar nga organet kompetente per ushtrimin e veprimtarise qe do te marrin persiper te realizojne me objektin e nenkontrates;
    - Nenkontraktoret duhet te provojne se kane aftesine teknike, (kualifikime profesionale, makineri dhe asete te tjera te nevojshme) per te realizuar veprimtarine qe do te marrin persiper me objektin e nenkontrates;
    - Nenkontraktoret duhet te provojne se zoterojne aftesine financiare per te realizuar veprimtarine qe do te marrin persiper me objektin e nenkontrates;
    - Subjekti do te zgjidhet nga Koncesionari si nenkontraktor duhet te kete eksperienca te ngjashme ne treg;

2. Ne perputhje me nenin 10 te Kontrates, Autoriteti nuk do te refuzoje miratimin kur provohet se nenkontraktuesi ploteson kushtet e mesiperme.
3. Ne perputhje me kerkesat e nenit 10 te kontrates, Koncesionari ka detyrim te mbaje te informuar Autoritetin lidhur me ecurine e nenkontratave.
4. Nenkontraktuesi ka detyrim perpara Autoritetit Kontraktues per ta njoftuar per:

    - Per cdo shkelje te detyrimeve nga ana e Koncesionarit, te marra persiper ne Nen-kontrate;
    - Per cfaredo shkaku qe mund te sjelle si pasoje zgjidhjen e Nen-Kontrates;

5. Nenkontraktuesi ka detyrimin per te ruajtur informacionin e konsideruar konfidencial ne Kontraten e Koncesiosnit.
6. Me perfundimin e Kontrates se Koncesionit do te perfun[illegible]t e lidhura nga Koncesionari. Pergjegjes perpara nenkontraktorev [illegible] ılyera apo pretendime per shperblim demi, do te mbetet Koncesion[illegible]

Aneksi VI

**Tarifa e Shërbimit të Kontrollit Teknik**

**A- Tarifat e shërbimit të kontrollit teknik (ekzistues) në datën efektive:**

| Nr. | TIPI I MJETIT | Çmimi në lek |
|---|---|---|
| 1 | Motomjete | 500 |
| 2 | Automjete me 4+1 vende | 1200 |
| 3 | Automjete me mbi 4+1 vende deri në 8+1 vende | 1500 |
| 4 | Kamione deri 3.5 ton | 1500 |
| 5 | Kamione nga 3.5 deri në 7.5 ton | 1800 |
| 6 | Kamione nga 7.5 deri në 18 ton | 2200 |
| 7 | Kamione mbi 18 ton | 2800 |
| 8 | Autobusë deri në 32 + 1 vende | 1700 |
| 9 | Autobusë me 32 deri 42 + 1 vende | 1900 |
| 10 | Autobusë mbi 42 + 1 vende | 2000 |
| 11 | Autobusë artikulare | 2000 |
| 12 | Rimorkio deri në 7 ton | 1200 |
| 13 | Rimorkio mbi 7 ton | 1500 |
| 14 | Mjete ndertimi deri në 7.5. Ton | 2000 |
| 15 | Mjete ndërtimi nga 7.5 deri në 18 ton | 2200 |
| 16 | Mjete ndërtimi mbi 18 ton | 2700 |
| 17 | Mjete nd/punim toke deri 7.5 ton | 1000 |
| 18 | Mjete nd/punim toke mbi 7.5 ton | 1100 |

...rbimit të Kontrollit Teknik

...shërbimit të kontrollit teknik (ekzistues) në datën efektive

**B- Tarifat e shërbimit të kontrollit teknik (të reja) që do të aplikohen pas realizimit me sukses nga Koncesionari SGS të fazës ndërtimore**

| Nr. | TIPI I MJETIT | Çmimi në lek |
|---|---|---|
| 1 | Motomjete | 800 |
| 2 | Automjete me 4+1 vende | 1800 |
| 3 | Automjete me mbi 4+1 vende deri në 8+1 vende | 2500 |
| 4 | Kamione deri 3.5 ton | 2700 |
| 5 | Kamione nga 3.5 deri në 7.5 ton | 2700 |
| 6 | Kamione nga 7.5 deri në 18 ton | 2700 |
| 7 | Kamione mbi 18 ton | 2700 |
| 8 | Autobusë deri në 32 + 1 vende | 2700 |
| 9 | Autobusë me 32 deri 42 + 1 vende | 2700 |
| 10 | Autobusë mbi 42 + 1 vende | 2700 |
| 11 | Autobusë artikulare | 2700 |
| 12 | Rimorkio deri në 7 ton | 2700 |
| 13 | Rimorkio mbi 7 ton | 2700 |
| 14 | Mjete ndertimi deri në 7.5. Ton (Autovinc, Betonjer) | 2700 |
| 15 | Mjete ndërtimi nga 7.5 deri në 18 ton | 2700 |
| 16 | Mjete ndërtimi mbi 18 ton | 2700 |
| 17 | Mjete nd/punim toke ( Tr. Rrugor etj) deri 7.5 ton | 2700 |
| 18 | Mjete nd/punim toke ( Tr. Rrugor etj) mbi 7.5 ton | 2700 |

**Aneksi nr VIII** **Plani i Projektit**

| Nr. | Pikesynimet | Afatet kohore |
|---|---|---|
| 1. | Themelimi i Shoqerise Koncensionare per zbatimin e Projektit | Data Efektive + 2 Jave |
| 2. | Paraqitja e projekt-zbatimit dhe e listes se nen-kontraktoreve per fazen e rinovimit te QKT ekzistuese | Data Efektive + 40 dite |
| 3. | Aplikimi per leje ndertimi per rindvimin e QKT ekzistuese (pas lidhjes se kontratave te uzufruktit) | T2 |
| 4 | Fillimi i punimeve per QKT ekzistuese | Ne momentin e marrjes se lejeve te ndertimit |
| 5 | Perfundimi i punimeve per QKT ekzistuese | T4 + 5 muaj |
| 6 | Paraqitja e listes se nenkontraktoreve per fazen e ndertimit te QKT se Re | Data efektive + 40 dite |
| 7 | Aplikimi per leje sheshi per QKT e Re | Data Efektive + 80 dite |
| 8. | Aplikimi per leje per ndertimin e QKT se re | Data e marrjes se lejes se sheshit + 45 dite |
| 9 | Fillimi i punimeve per QKT e Re | Ne momentin e miratimit te lejes se ndertimit |
| 10 | Perfundimi i punimeve per QKT e Re | T9 + 6 muaj |

***Aneksi VIII***

Grafiku I Punimeve

## SHQIPERIA – PLANI I IMPLEMENTIMIT TE RINOVIMIT/NDERTIMIT TE 14/1 QKT

| JAVA E FILLIMIT | |
|---|---|

| LOT | RAJ | QKT N | VENDNDODHJA | JAVE PUNE 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2 | Lac | | | | | | | | | | | | ■ | ■ | ■ | | | | | | | | | | | | |
| | | 3 | Shkoder | | | | | | | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 4 | Diber | | | | | | | | | | | | | | | | | | ■ | ■ | ■ | | | | | | |
| | | 5 | Kukes | | | | ■ | ■ | ■ | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 6 | Durres | ■ | ■ | ■ | | | | | | | | | | | | ■ | ■ | ■ | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | MESME | 1 | Tirana e re | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ |
| | | 1* | Tirana aktuale | | | | | | | | | | | | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | | | | | | | | | |
| | | 7 | Elbasan | | | | ■ | ■ | ■ | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 8 | Lushnje | | | | | | | ■ | ■ | ■ | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 9 | Fier | | | | | | | | | | ■ | ■ | ■ | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | JUG | 10 | Berat | | | ■ | ■ | ■ | ■ | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 11 | Korce | | | | | | | ■ | ■ | ■ | ■ | ■ | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | 12 | Vlore | | | | | | | | | | | | | | | | | ■ | ■ | ■ | | | | | | | |
| | | 13 | Gjirokaster | | | | | | | | | | | | ■ | ■ | ■ | | | | | | | | | | | | |
| | | 14 | Sarande | | | | | | | | | | | | | | | ■ | ■ | | | | | | | | | | |

AFATI I PERFUNDIMIT TE PUNIMEVE DHE DOREZIMIT - 20 JAVE

AFATI PER NDERTIMIN DHE PAJISJEN E QKT SE RE NE TIRANE 26 JAVE

54

## Aneksi IX

## PENALITETET

### I. Penalitet e Zbatueshme ne Rast Vonese

Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Pagesat e Voneses si vijon:

**1.Themelimi i Shoqerise se re Koncesionare per Zbatimin e Projektit.**

Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktor nje penalitet si vijon per cdo jave vonesë te filluar ne te cilen Koncesionari deshton ne themelimin e shoqerise se re koncesionare,(sic percaktohet ne Aneksin VIII):

100 000 Leke me filllimin e javës së parë të vonesës;
200 000 Leke me fillimin e javës së dytë të vonesës;
300 000 Leke me fillimin e javës së tretë të vonesës;
400 000 Leke me fillimin e javës së katërt të vonesës;
500 000 Leke me fillimin e javës së pestë të vonesës;

Shuma maksimale e penaliteteve per keto vonesa do te jete ne total
1 500 000 Leke.
Pas javes se peste te voneses, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë te zgjidhe pa paralajmerim Kontraten.

**2. Aplikimi per Leje, Autorizime dhe/ose Licensa per efekt te Fillimit te Punimeve**

Koncesionari do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues një penalitet si vijon për cdo javë vonesë, përjashtuar javën e parë të falur, në të cilën Koncesionari dështon të paraqesë pranë autoriteteve kompetente dokumentacionin e plotë sipas kërkesave të ligjit, Aplikimin për Leje, Autorizime dhe/ose Licensa per efekt te Fillimit te Punimeve.

Java e parë është periudhë falje.
250 000 Leke me fillimin e javës së dytë të vonesës;
375 000 Leke me fillimin e javës së tretë të vonesës;
500 000 Leke me fillimin e javës së katërt të vonesës;
625 000 Leke me fillimin e javës së pestë të vonesës;

Shuma maksimale e penaliteteve per keto vonesa do te jete ne total
1 750 000 Leke.
Pas javes se peste te voneses, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë te zgjidhe pa
paralajmërim Kontraten.

## 3. Perfundimi i Punimeve per OKT-te Ekzistuese

Koncesionari do t'i paguaje Autoritetit Kontraktor nje penalitet si vijon per çdo ditë vonese, përveç dy javëve të para, ne te cilen Koncesionari deshton ne perfundimin e punimeve (sic percaktohet ne Nenin 18.2.2).

Dy javet e para jane periudhe falje.
Per çdo ditë vonesë ne vazhdim, Konçesionari do të paguajë një penalitet ditor 200 000 (dyqind mije) Leke, shume te ciles i shtohet fitimi i munguar i Autoritetit Kontraktues nga mosaplikimi i tarifave te reja per numrin e mjeteve te testuara deri ne diten e fillimit te aplikimit te tarifave reja, por gjithsesi deri në 8 (tetë) javë vonesë (duke përfshirë dy javët e faljes).

Menyra e llogaritjes se fitimit te munguar per nje mjet eshte si vijon:

$$(a - b) \times c = d$$

tarifat e reja (a),
tarifa ekzistuese(b),
Tarifa e Koncesionit(c),
fitimi i munguar (d)

Ne asnje rast, Koncesionari nuk mund te kerkoje ulje perpjestimore te penalitetit sipas ketij paragrafi per pjesen e realizuar te investimit deri ne momentin e voneses. Pas afatit tetë javor Autoriteti Kontraktues ka te drejtë të zgjidhë Kontratën pa paralajmerim.

## 4. Perfundimi i Punimeve per OKT-ne e Re

Koncesionari do t'i paguaje Autoritetit Kontraktor nje penalitet si vijon per çdo ditë vonese, përveç dy javëve të para, ne te cilen Koncesionari deshton ne perfundimin e punimeve (sic percaktohet ne Nenin 18.2.3).

Dy javet e para jane periudhe falje.
Per çdo ditë vonesë ne vazhdim, Konçesionari do të paguajë një penalitet ditor prej 400 000 (katerqind mije) leke, por deri në 8 (tetë) javë vonesë (duke përfshirë dy javët e faljes). Ne asnje rast, Koncesionari nuk mund te kerkoje ulje perpjestimore te penalitetit sipas ketij paragrafi per pjesen e realizuar te investimit deri ne momentin e voneses. Pas afatit tetë javor Autoriteti Kontraktues ka te drejtë të zgjidhë Kontratën pa paralajmerim.

## 5. Faza e Shfrytëzimit dhe e Mirëmbajtjes

Për çdo mospërmbushje te detyrimeve kontraktore nga Konçesionari te percaktuara ne pikat 18.2.4, 18.2.5, 18.2.7, 18.2.11, dhe 18.2.14 gjatë kësaj faze, ky i fundit paguajë Autoritetit Kontraktues penalitetet si më poshtë:

Per piken 18.2.4, do te aplikohet penalitet vetem nese Autoriteti Kontraktues konstaton shkelje per te dyten here ne QKT-te sipas kesaj pike me kusht qe Koncesionari te jete njoftuar me shkrim si dhe te jete derguar raporti perkates i inspektimit nga Autoriteti Kontraktues per konstatimin ne heren e pare. Penaliteti do te aplikohet per numrin e diteve te mospermbushjes duke filluar nga njoftimi i dyte i cili nuk mund te dergohet me shpejt se 3 tre dite nga njoftimi i pare.

Per piken 18.2.5, do te aplikohet penalitet vetem nese Autoriteti Kontraktues konstaton per te treten here ne te njejten QKT parregullsi ne zbatimin e orarit sipas kesaj pike me kusht qe Koncesionari te jete njoftuar me shkrim si dhe te jete derguar raporti perkates i inspektimit nga Autoriteti Kontraktues per dy rastet e para. Penaliteti do te aplikohet per numrin e diteve te mospermbushjes duke filluar nga njoftimi i trete.

Per piken 18.2.7, do te aplikohet penalitet vetem nese Autoriteti Kontraktues konstaton per te treten here ne te njejten QKT te njejten lloj parregullsie me kusht qe Koncesionari te jete njoftuar me shkrim si dhe te jete derguar raporti perkates i inspektimit nga Autoriteti Kontraktues per dy rastet e para. Penaliteti do te aplikohet per numrin e diteve te mospermbushjes duke filluar nga njoftimi i trete.

Per piken 18.2.11, do te aplikohet penalitet vetem nese Koncesionari nuk paraqet informacionin e kerkuar me shkrim nga Autoriteti Kontraktues per te dyten here radhazi.

Per piken 18.2.14 aplikimi i penaliteteve do te llogaritet pas nje periudhe faljeje prej 2 (dy) javesh nga data e perfundimit te Periudhes Koncesionare.

Penalitetet do te jene si me poshte:

1) 100 000 Leke për çdo ditë mospërmbushjeje nga dita e 1-rë deri në ditën e 30-të të mospërmbushjes;
2) 400 000 Leke për çdo ditë mospërmbushjeje nga dita e 31-të deri në ditën e 60-të të mospërmbushjes;
3) 700 000 Leke për çdo ditë mospërmbushjeje nga dita e 61-të deri në ditën e 90-të të mospërmbushjes.

Shuma totale e penaliteteve, të cilën ka të drejtë ta përfitojë Autoriteti Kontraktues gjatë Fazës së Shfrytëzimit, nuk do ta kalojë shumën prej 36 000 000 (tridhjete e gjashte milion) Leke.

Penalitetet si më sipër do të jenë të pavarur nga njëri-tjetri dhe asnjë tavan nuk do të aplikohet, përveç kufizimeve kohore sipas parashikimeve më sipër.

Penalitet si më sipër do të jenë të detyrueshme për t'u paguar pavarësisht nëse Autoriteti Kontraktues mund të ketë kërkuar zgjidhjen e kësaj Kontrate në përfundim të afateve

kohore si më sipër për aplikimin e tyre.

Çdo pagesë penalitetesh duhet do t'i bëhet Autoritetit Kontraktues nga Konçesionari, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të Autoritetit Kontraktues në të cilin përcaktohen shumat e penaliteteve. Nëse Konçesionari nuk paguan këto penalitete brenda këtij afati, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë t'i marrë ato nga Sigurimi i Kontratës. Për aq sa shuma e penaliteteve për t'u paguar nga Konçesionari e kalon shumën e Sigurimit të Kontratës, Autoriteti Kontraktues Konçesionari do të ketë të drejtë t'i drejtohet gjykatës lidhur me detyrimin e Konçesionarit për pagimin e tyre.

Ne rastin e mospermbushjes se detyrimeve per te cilat eshte parashikuar paraprakisht pagese penaliteti zgjidhja e kontrates mund te kerkohet sipas procedures se parashikuar ne nenin 23 Zgjidhja e Kontrates pasi te jete ezauruar procedura e penaliteteve.

Ne rastin e mospermbushjes se detyrimeve per te cilat nuk eshte paras paraprakisht pagese penaliteti zgjidhja e kontrates mund te kerkohet drejtpersedrejti sipas procedures se parashikuar ne nenin 23 Zgjidhja e Kontrates.

**Aneksi X**

## Procedura e Zgjidhjes se Mosmarrveshjeve

Permbajtja

1. Hyrje/ Historik
2. Shkallet
3. Performanca e Vazhdueshme

### 1. Hyrje

1.1 Cdo mosmarrveshje do te zgjidhet ne perputhje me Proceduren e Zgjidhjes se Mosmarreveshjeve te percaktuar ne kete Aneks.

### 2. Shkallet

2.1 Nese ndermjet Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit do te linde ndonje ceshtje qe perben shqetesim, atehere Palet do te bejne te gjitha perpjekjet e arsyeshme per ta zgjidhur nje ceshtje te tille ne menyre sa me te shpejte dhe praktike qe te jete e mundeshme, ne ate nivel qe nje mosmarrveshje e tille do te krijohet. Minimalisht palet do te sigurojne se e kane diskutuar ceshtjen ne driten e fakteve qe lidhen me ceshtjen, qe e kane kaluar ate neper nivelet operative, menaxheriale dhe ekzekutive te shqyrtimit (sipas mundesise) dhe se kane bere te gjitha perpjekjet e arsyeshme per te arritur ne nje zgjidhje.

2.2 Sipas Paragrafit 4 te ketij Aneksi, kur Palet nuk arrijne nje zgjidhje per mosmarreveshjen, ato do te perpiqen t'i zgjidhin ne funksion te pershkallezimit te mosmarrveshjes, duke perdorur Procesin e Shkallezimit te percaktuar ne kete Aneks perpara nisjes se cdo procedure tjetër për zgjidhjen e mosmarrveshjes.

2.3 Kur lind nje ceshtje, e cila nuk mund te zgjidhet ne ate nivel qe kjo ceshtje lind atehere Autoriteti Kontraktues ose Koncesionari mund ta dergojne ate prane nivelit tjeter ne procesin e Shkallezimit.

2.4 Procesi i Shkallezimit synon te jete nje udhezues per palet lidhur me zgjidhjen e ceshtjeve ne menyre po aq te shpejte sa ato lindin. Synimi nuk eshte qe Procesi i Shkallezimit te funksionoje ne menyre jo fleksibel apo ne nje menyre te tille qe pengoje zgjidhjen e nje ceshtje ne nivelin me te pershtatshem dhe sa me shpejt qe te jete e mundur.

2.5 Kur, ne cdo nivel, vendoset qe ceshtja ka kaluar neper shkalle sipas menyres se duhur, Palet do te bejne te gjitha perpjekjet e arsyeshme per ta zgjidhur ceshtjen.

2.6 Kur pranohet nje zgjidhje, vendimi se bashku me planin e zbatimit do te raportohen me shkrim.

2.7 Kur nje ceshtje nuk mund te zgjidhet ne nje nivel, atehere ajo do te kalohet ne nivelin tjeter me te larte ne perputhje me Paragrafin 2.4 me siper.

2.8 Pervec rastit kur nje ceshtje kerkon nje zgjidhje te shpejte, ku veprimet Kontraktues jane ose mund te ndikohen negativisht ose kur secila Pale m

kosto domethenese si rezultat i moszgjidhjes se ceshtjes, referimi i ceshtjes do te behet me raport te shkruar per tek niveli tjeter nga Pala e cila referon ceshtjen. Raporti do te permbaje, te pakten informacionin e meposhtem.

- Emrin dhe adresen e iniciatorit;
- Data kur eshte ngritur ceshtja per here te pare;
- Pershkrimi i ceshtjes, duke perfshire cdo histori me probleme te ngjashme;
- Implikimet e ceshtjes, seriozitetin e saj dhe shkallen e urgjences qe kerkohet;
- Nje vleresim te kostos aktual dhe potenciale te ceshtjes; dhe
- Emrat dhe adresat e te tjereve te perfshire, te cilet mund te kete nevoje te konsultohen.

2.9 Brenda 5 (pese) dite pune nga marrja e vendimit per shkallezimin, iniciatori dhe homologu i tij do te pergatisin dhe pranojne nje raport per nivelin tjeter dhe homologut do t'i jepet nje kopje e raportit. Kur raporti nuk mund te pranohet, atehere cdo verejtje shtese qe mund te kerkoje Pala tjeter, do t'i bashkelidhet raportit.

2.10 Sapo raporti te jete dorezuar, personat perkates te nivelit te dhene do te kontaktojne me njeri-tjetrin sa me shpejt te jete e mundur per te zgjidhur ceshtjen qe eshte subjekt i referimit brenda nje periudhe shtese prej 5 (pese) ditesh pune pas se ciles, ceshtja do te referohet ne nivelin pasardhes ose, do te zbatohen, ne vijim te referimit te nivelit 4, procedurat e percaktuara ne paragrafet 3, 4 dhe 5.

Nivelet e shkallezimit jane si me poshte vijon:

| Niveli | Autoriteti | Koncensionari |
|---|---|---|
| Niveli 1 | Perfaqesuesi i Autoritetit Kontraktues | Përfaqësuesi ligjor i Kompanise Koncesionare |
| Niveli 2 | Zëvendësministri i pajisur me autorizim nga Ministri cdo fillim viti për ndjekje dhe mbikqyrje të kësaj kontrate koncesionre | Përfaqësuesi ligjor i Kompanise Koncesionare |
| Niveli 3 | Ministri i Autoritetit Kontraktues | Ortaku i vetem i Shoqerise Koncesionare |

### 3. Performanca e vazhdueshme

3.1 Autoriteti Kontraktor dhe Koncesionari do te vazhdojne permbushjen e detyrimeve të tyre sipas kesaj Kontrate ne pritje te zgjidhjes se mosmarrveshjes, me kı qe permban ky Aneks nuk pengon apo kufizon Palet ne lidhje me ligjshem te te drejtave te tyre sipas Nenit 40 te Kontrates, ne cdo kohe.

**Aneksi XI**

**Formulari i Sigurimit të Kontratë**